



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2020:103543
Datë: 08.11.2024
Numri i dokumentit: 06423279

C.nr.325/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Feim Bytyqi, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen juridike të paditësve S.Th, L.H, Q.M, E.G, R.G, F.V, V.K që të gjithë nga Rahoveci të cilët me autorizim i përfaqëson Av. Z.H nga Prishtina kundër të paditurës Komuna e Rahovecit Drejtoria e Shëndetësisë Rahovec të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar V.G, me objekt kontesti kompensimi nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 23,940.00 euro, në seancën gjyqësore me dt. 28.10.2024 merr, ndërsa me datë 07.11.2024 përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET se padia e paditësve S.Th, L.H, Q.M, E.G, R.G, F.V, V.K që të gjithë nga Rahoveci, në këtë çështje juridiko - civile është TËRHEQË.

Shpenzimet e procedurës i bartin paditësit.

A r s y e t i m

Paditësit S.Th, L.H, Q.M, E.G, R.G, F.V, V.K që të gjithë nga Rahoveci, pranë kësaj gjykate me datë 20.08.2020, nëpërmjet të autorizuarit të tyre Av.Z.H nga Prishtina, kanë ushtruar padinë kundër të paditurës Komuna e Rahovecit, Drejtoria e Shëndetësisë, Rahovec, me objekt kontesti kompensimi nga marrëdhënia e punës, me vlerë të kontestit 23,940.00 euro.

Në bazë të padisë së paditësve, gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit përgatitor për datë 28.10.2024.

I autorizuari i paditësve Av.Z.H nga Prishtina ka munguar në seancë edhe pse ftesën e ka pranuar me rregull dhe mungesën e tij nuk e ka arsyetuar, ndërsa për të paditurën është paraqitur personalisht në seancë përfaqësuesi i autorizuar V.G i cili i ka propozuar gjykatës që padinë e paditësve ta konsideroj të tërhequr pasi që mungon në seancë i autorizuari i paditësve.

Në dispozitën e nenit 423.3 të LPK-së është paraparë që: “Në qoftë se paditësi nuk vjen në seancën kryesore, edhe pse është thirrur rregullisht, konsiderohet se e ka tërhequr padinë, përveçse kur i padituri deklaron se kërkon që të zhvillohet shqyrtimi kryesor i çështjes në mungesë të paditësit.”

Andaj, Gjykata në kuptim të dispozitës nga neni 423.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL

C.nr.325/2024, dt. 07.11.2024

B. Profesional
Armond Qmega

Gjyqtari
Feim Bytyqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimet të këtij aktvendimi. Ankesa paraqitet nëpërmjet kësaj gjykate për gjykatën e Apelit në Prishtinë – Divizioni Civil.